

KATEGORIA QË I PËRKET SIPAS Vendimit Nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave “Përdisa ndryshime në VKM 903, dt. 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Student, familja e të cilit trajtohet me ndihmë ekonomike.</li> </ul> <p><b>*Dokumentat shoqëruese:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vërtetim që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike, ku të specifikohet masa e ndihmës ekonomike (vlera e shprehur me shifra dhe fjalë) dhe koha e përfitimit të ndihmës ekonomike – dokument origjinal lëshuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore, e shoqëruar me numër protokolli;</li> <li>2. Vërtetim shkolle (për bursë) nga sekretaritetë mësimore;</li> <li>3. Certifikatë familjare;</li> <li>4. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).</li> </ol>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë.</li> </ul> <p><b>*Dokumentat shoqëruese:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vërtetimet e të dy bashkëshortëve që janë studentë në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokaster;</li> <li>2. Vërtetim shkolle (për bursë) nga sekretaritetë mësimore;</li> <li>3. Certifikatë familjare;</li> <li>4. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).</li> </ol>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Student, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.</li> </ul> <p><b>*Dokumentat shoqëruese:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vendim i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë;</li> <li>2. Vërtetimi origjinal nga njësia e vetëqeverisjes vendore për masën e pagesës së paaftësisë që merr studenti;</li> <li>3. Vërtetim shkolle (për bursë) nga sekretaritetë mësimore;</li> <li>4. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).</li> </ol>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Student, që i ka të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.</li> </ul> <p><b>*Dokumentat shoqëruese:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vendimet (e të dy prindërve) të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë;</li> <li>2. Vërtetimi origjinal nga njësia e vetëqeverisjes vendore për masën e pagesës së paaftësisë për secilin nga të dy prindërit;</li> <li>3. Vërtetim shkolle (për bursë) nga sekretaritetë mësimore;</li> </ol>	

<p>4. Certifikatë familjare; 5. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).</p>	
<p>• Student, që i ka të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton. <b>*Dokumentat shoqëruese:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vërtetim (të të dy prindërve) nga DRSSH Gjirokastrë që janë pensionistë;</li> <li>2. Në rast kur jeton vetëm një prind, vërtetim nga DRSSH të prindit në pension dhe certifikatë vdekjeje të prindit të ndarë nga jeta;</li> <li>3. Vërtetim shkolle (për bursë) nga sekretaritetë mësimore (në të dyja rastet);</li> <li>4. Certifikatë familjare (në të dyja rastet);</li> <li>5. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).</li> </ol>	
<p>• Student, që janë të tretët e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë. <b>*Dokumentat shoqëruese:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vërtetimet që janë studentë në institucionet e arsimit të lartë publik, e të dy fëmijëve para të tretit, që rezultojnë në certifikatën familjare;</li> <li>2. Vërtetimqëështëstudentë në Universitetin “Eqrem Çabej”, të studentit që përfiton;</li> <li>3. Vërtetim shkolle (për bursë) nga sekretaritetë mësimore;</li> <li>4. Certifikatë familjare;</li> <li>5. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).</li> </ol>	
<p>• Student, që ka përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç. <b>*Dokumentat shoqëruese:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fotokopje e noterizuar e librezës së statusit të jetimit, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;</li> <li>2. Vërtetim shkolle (për bursë) nga sekretaritetë mësimore;</li> <li>3. Certifikatë familjare;</li> <li>4. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).</li> </ol>	
<p>• Student, që ka humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç. <b>*Dokumentat shoqëruese:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vendimi i gjykatës i formës së prerë për humbjen e kujdestarisë prindërore;</li> <li>2. Vërtetim shkolle (për bursë) nga sekretaritetë mësimore;</li> <li>3. Certifikatë familjare;</li> <li>4. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).</li> </ol>	
<p>• Student, që është identifikuar si viktimë e trafikut të qenieve njerëzore dhe ka përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç. <b>*Dokumentat shoqëruese:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vërtetim për përfitim të statusit ligjor për trajtim si viktimë e trafikut të qenieve njerëzore nga Drejtoria e Përgjithëshme Antitrafik në Ministrinë e Brendshme;</li> <li>2. Vërtetim shkolle (për bursë) nga sekretaritetë mësimore;</li> </ol>	

<p>3. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).</p>	
<p>• Student, fëmijë i punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.</p> <p><b>*Dokumentat shoqëruese:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vërtetim apo dokument tjetër nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ajoe mbrojtjes që konfirmon se studenti është fëmijë i punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;</li> <li>2. Vërtetim shkolle (për bursë) nga sekretaritetë mësimore;</li> <li>3. Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).</li> </ol>	